

## Jetë shkrim

**Haki Myrteza Çako,**

Drejtor i Përgjithshëm,

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

[Haki.cako@hotmail.com](mailto:Haki.cako@hotmail.com)

[Haki.cako@akmc.gov.al](mailto:Haki.cako@akmc.gov.al)

Cel.+355697070704

Haki **Çako** është një personalitet dhe një lider i shquar në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes Civile në Shqipëri. Lindur më **4 prill 1967**, në Lushnjë, ai tani banon në Tiranë. Është i martuar dhe ka dy fëmijë.

Me një përvojë të gjatë dhe të pasur në **fushën e sigurisë publike dhe mbrojtjes civile**, ai ka shërbyer në pozita të rëndësishme në strukturat e Policisë së Shtetit dhe më pas në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

### **Fusha profesionale.**

Haki **Çako** është diplomuar si Specialist i lartë policie në Akademinë e Sigurisë në Tiranë dhe ka një diplomë në juridik, me një master profesional në fushën penale, nga Fakulteti Juridik i Universitetit "Ismail Qemal" në Vlorë. Ai ka filluar karrierën e tij në strukturat e Policisë së Shtetit në shtatorin e vitit 1988 dhe ka shërbyer më pas në të gjitha nivelet dhe funksionet e Policisë së Shtetit deri në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, me gradën e lartë policore, **DREJTUES MADHOR**.

Ka shërbyer në funksione drejtuese, kryesisht në struktura të hetimit të krimeve, Specialist, Shef i Policisë Kriminale, Shef Komisariati, Drejtor i Policisë në Nivel Qarku, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për Hetimin e Krimeve të Rënda dhe Krimin e Organizuar, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit si dhe , në rrethet Tiranë, Kuçovë, Shkodër, Vlorë, Elbasan, Gjirokastër etj.

Është trajnuar dhe certifikuar si pjesëmarrës në shumë workshope, seminare dhe trajnime të organizuar nga partnerët strategjik të Policisë së Shtetit, si ICITAP/ USA, MAPE & PAMECA/BE, OSBE, etj.

Ka qenë pjesëmarrës dhe drejtues në shumë operacione të suksesshme policore.

Është njohës i mirë i legjislacionit të së drejtës, në veçanti atij penal.

### **Drejtues/ekspert në sistemin kombëtar të mbrojtjes civile.**

Përveç përvojës së tij në fushën e policisë, Haki **Çako** ka kontribuar ndjeshëm në zhvillimin dhe përparimin e sistemit të mbrojtjes civile në Shqipëri. Emërohet si **këshilltar** i Ministrisë së Mbrojtjes për çështje të emergjencave civile, në prill të vitit 2018, më pas si Drejtor i Përgjithshëm i Emergjencave Civile dhe më pas më **20.11.2019**, me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. **741**, emërohet si **Drejtor i Përgjithshëm** i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, detyrë të cilën kryen edhe aktualisht.

Haki **Çako** ka luajtur një rol kyç në procesin e **reformës legislative**, organizative dhe strukturës së sistemit të mbrojtjes civile kombëtare. Ai ka kontribuar në hartimin dhe miratimin e ligjit 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe dokumenteve strategjike kombëtare, duke siguruar një qasje koordinuar dhe efektive për menaxhimin e emergjencave dhe përparimin e mbrojtjes civile në vend; si **Vlerësimi i Risqeve nga Fatkeqësitë, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Risqeve nga Fatkeqësitë** si dhe **Plani Kombëtar të Emergjencave Civile**; si dhe akte e tjera ligjore dhe nënligjore brenda fushës së përgjegjësisë.

Ka organizuar, drejtuar dhe menaxhuar krijimin dhe funksionimin e **Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC)**, si një institucion risi në fushën e mbrojtjes civile, duke finalizuar me sukses anëtarësimin e Shqipërisë në **Mekanizmin e Unionit European të Mbrojtjes Civile (UCPM)**.

Ka një marrëdhënie dhe koncept lideri në drejtim, koordinim dhe menaxhim me ekipin që drejton, përfaqësuesit e institucioneve dhe strukturave të sistemit të mbrojtjes civile por edhe partnerët ndërkombëtar në misionin e konsolidimit të mbrojtjes civile.

Haki **Çako** përfaqëson autoritetin kombëtar të Mbrojtjes Civile në përfaqësitë e rëndësishme si **DG ECHO/EU** dhe **UFM** (Unioni për Menaxhimin e Fatkeqësive në Mesdhe), si dhe para partnerëve të huaj dhe në të gjitha projektet e bashkimit evropian lidhur me mbrojtjen civile dhe implementimin e tyre bazuar në direktivat e **BE-së**, kuadrin e **Sendait** dhe Marrëveshjen e **Parisit** për Klimën.

Drejton **Këshillin Teknik Konsultat Kombëtar** për çështje të emergjencave civile, si dhe është anëtar i Komitetit të Mbrojtjes Civile.

Merr pjesë në cilësinë e anëtarit të **Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha**, **Komitetit Kombëtar për Aviacionin Civil**, **Sekretariatit e Menaxhimit të KESH**, etj.